

VNMS për Rehabilitimin e Linjës Hekurudhore Vorë – Hani i Hotit



Vorë më 05.12.2022

GJENDJA E HEKURUDHËS DHE SYNIMI I PROJEKTIT

Të përgjithshme

- Cjatësi rreth 120 km nga Vora në Hanin e Hotit;
- Ndërtuar në vitet 1960 (Vorë-Lac) dhe vitet 1980 (Lac-Hani Hotit);
- Momentalisht hekurudha në këtë segment nuk plotëson asnjë standard bashkëkohor

Gjendja e Hekurrudhës

- Traseja, dhe traversat në gjendje të keqe;
- Shpejtësia maksimale: 40km/orë. Në disa vende: 20km/orë;
- Kryqezime të paautorizuara me rrugët vendore dhe kombëtare;
- Sistemi i sinjalizimit nuk egziston;
- Urat të dëmtuara dhe jashtë standarteve Europiane (Lumi Ishëm, etj.);
- Tombinot kanë shpesh diametër të vogël;
- Ndërtesat e stacioneve dhe platformat janë dëmtuar;
- Burim aksidentesh



GJENDJA E HEKURUDHËS DHE SYNIMI I PROJEKTIT

Symimet e rehabilitimit të hekurudhës

- Shpejtësi maksimale prej 120km/orë;
- Rehabilitim i trasesë, gjurmës gjatësore dhe lartësisë;
- Zgjerimin e trasesë në 6.6m, për të mundësuar elektrifikimin;
- Prishja e të gjitha urave, tombinove dhe ndërtesave e platformave të stacioneve dhe ndërtimi i tyre sipas normave Europiane (EN);
- Mbyllja e kalesave të paligjshme;
- Ndërtimi i kalesave të sigurta;
- Ndërtimi i rrugëve ndihmese, të lidhura me kalesat e sigurta;
- Rrethimi me gardh i hekurudhës dhe stacioneve;
- Ndërtimi i një sistemi bashkekohor sinjalizimi;
- Ndërtimi i pengesave kundër zhurmës; etj.



SHTRIRJA E PROJEKTIT

Bashkia Vorë

Km 20+780 ne km 27+440 (stacioni Vore – Budull);

Bashkia Krujë

Km 27+440 ne km 41+070 (Budull – kalesa Bushnesh);

Bashkia Kurbin

Km 41+070 (kalesa Bushnesh) ne km 55+100 (lumi Mat)

Bashkia Lezhë

Km 55+100 (ana e majte e lumit Mat) ne km 85+500 (Nenshat)

Bashkia Vau i Dejës

Km 85+500 (Nenshat) ne km 95+300 (Ganjolle)

Bashkia Shkodër

Km 95+300 (Ganjolle) ne km 111+500 (Perroi Vrakes)

Bashkia Malësi e Madhe

Km 111+500 (Ura Vrakes) ne km 140+000 (Hani i Hotit)



PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Stacionet

1. Budull;
2. Ishem;
3. Mamurras;
4. Gjorm;
5. Laç;
6. Milot (Në vendin ekzistues);
7. Lezhë 1 (Në vendin ekzistues);
8. Lezhë 2 (Stacion i ri i vendosur në Zonën Industriale të Lezhës);
9. Baqel (Në vendin ekzistues);
10. Mjedë (Në vendin ekzistues);
11. Shkoder (Në vendin ekzistues);
12. Koplik (Ky stacion udhetaresh do të zhvendoset rreth 400 m në veri)
13. Bajzë (Në vendin ekzistues);
14. Hani Hotit (Stacioni i Hani Hotit nuk është pjesë e Projektit)




PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Traseja dhe brezi hekurudhor:

Rripi i tokës me gjerësi të paktën 5m në të dy anët, duke filluar nga kanalet kulluese, i perket Hekurudhës Shqiptare.

Ky rrip toke quhet brezi hekurudhor. Sipas kodit hekurudhor (ligji Nr. 142/2016) ;


Brezi hekurudhor eshte prone e Hekurudhes Shqiptare.



PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Kalesat në Nivel

Në total janë projektuar **54 vendkalime në nivel** nga Vora në Han të Hotit. Të gjitha këto nënkalime do të sigurohen. Detajet mbi projektimin dhe funksionimin e kalimeve në nivel janë dhënë në Hartimin e Detajuar të Projektit. Vendndodhja e kalimeve në nivel të projektuar bazohet në ato ekzistuese të autorizuar, në rrjetin e rrugëve lokale, vendbanimet ekzistuese dhe nevojat e komuniteteve lokale, si dhe në standardet e kërkuara për shpejtësinë dhe kalimet në nivel të trenave.



Rrugët e Shërbimit

Këto kalesa në nivel do të mundësojnë kalimin në anët e ndryshme të hekurudhës dhe për këtë arsye do të ndërtohen gjithashtu për të gjithë gjatësinë e gjurmës në total rreth **112 km rrugë** përgjithësisht paralele me hekurudhën për të aksesuar këto kalesa të autorizuar. Këto rrugë shërbimi do të kenë gjerësi 4 metra dhe do të jenë të paasfaltuara.

PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Urat

Pothuajse të gjitha urat kryesore ekzistuese do të prishen dhe do të ndërtohen te reja, afërsisht në të njëjtin vend.

Ura e Matit dhe e Kirit nuk do të prishen për shkak të funksionit të dyfishtë që mundëson transportin rrugor dhe hekurudhor.

Ura të reja paralele dhe të bashkuara me ato ekzistuese do të ndërtohen në vendkalimet e lumenjve Mat dhe Kir. Ndërsa urat e Spatharit 1 dhe 2 nuk do të prishen për shkak të funksionit të tyre si struktura hidroteknike, të cilat funksionojnë si argjinatura dhe si ura hekurudhore.

Kodi	Emri ures	Vendndodhja	Gjatesia e ures egzistuese
B01	Ishmi	35+071	210.00m
B02	Droja	41+834	70.10m
B03	Mati-Miloti	56+097	781.21m
B04	Lezhe 1	67+757	140.10m
B05	Lezhe 2	69+679	90.10m
B06	Spathara 1	94+458	108.10m
B07	Spathara 2	94+939	248.35m
B08	Kiri	102+980	144.10m
B09	Vraka	111+547	47.44m
B10	Rjolli	118+044	118.45m
B11	Banushi	120+977	70.10m
B12	Perroi i thate	127+092	70.10m

Urat e vogla :Jane planifikuar 74 ura të vogla, nga Vora ne Hanin e Hotit. Shumica e tyre do të zëvendësojnë ato ekzistueset, të cilat do të prishen. Projektimi I detajuar ka shtuar disa ura të reja të vogla në vende të reja.

PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Tombinot

Gjithsej do të ndërtohen **304 tombino**, drejtkendeshe ose cilindrike. Tombinot e reja do të zëvendësojnë ato ekzistueset, të cilat do të prishen. Diametri i tombinove egzistuese cilindrike luhatet nga 0.6 në 1.2 m. Diametri i tombinove te reja drejtkendeshe do të jetë 2x2, 3x2 dhe 4x2.5 m. Ndërsa diametri i tombinove cilindrike do të jete 1.2 m.


Muret mbajtëse

Muret mbajtëse janë projektuar për mbrojtje nga erozioni, përfshirë erozionin e lumenjve dhe përrenjve.

Të gjitha muret mbajtëse ekzistuese do të prishen dhe do të zëvendësohen me të reja. **Gjithsej 58 mure** mbajtëse do të rehabilitohen/ndërtohen gjate gjithë linjës hekurudhore, nga Vora ne Hanin e Hotit.

Tuneli i Lezhes

Tuneli i Lezhes do të zgjerohet për të bërë të mundur elektrifikimin e ardhshëm të hekurudhës. Nuk do të përdoren lende plasuese për zgjerimin e tunelit.



PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT


Rrethimi hekurudhes dhe stacioneve

Linja hekurudhore do te rrethohet plotësisht, me gardh. Rrethimi do të jetë i dy tipeve: Tipi A do të zbatohet për linjen e hapur dhe tipi B për stacionet.


Lartesia e gardhit ne linje te hapur do te jete 1.90m, ndersa ne stacione do te jete 2.10m.

Gardhi do të instalohet brenda zonave të stacioneve dhe korridorit hekurudhor që janë pronë e HSH.



Typical Fencing -Type A - Open Line



Typical Fencing - Railway Station




Barrierat kunder zhurmes do te ndertohen ne zonat me popullsi te dendur ose midis hekurudhes dhe objekteve te ndjeshme sikurse jane shkollat, spitalet, etj.



PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT



Sistemi i sinjalizimit

- Sherben per sigurine e hekurudhes;
- Lidhet me dispecerine qendrore, ne Shkozet (ose Vore);
- Lidhja me stacionet behet me vale radio, antenat e te cilave vendosen ne stacione dhe ne lokomotiva.
- Sistemi i sinjalizimit te kalesave ne nivel per linjen e hapur do lidhet me dispecerine qendrore, ndersa kalesat e stacioneve lidhen edhe me stacionet edhe me dispecerine qendrore.



Sistemi i vezhgimit:

stacionet dhe kalesat ne nivel do te kontrollohen me video



PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Bashkia Vorë


Km 20+780 ne km 27+440 (stacioni Vore – Budull);

Urat: Te gjitha urat do te prishen dhe ne vend te tyre do te ndertohen ura te reja, me gjeresi 6.0m;

Tombinot: Te gjitha tombinot do te prishen dhe ne vend te tyre do te ndertohen tombino te reja, me permasa me te medha;

Kalesat ne nivel: Mbyllen kalesat e paautorizuara; Kalesat do te jene te sigurta

No	Vendndodhja	Gjeresia rruges (m)	Sqarim
1	Km 22+138	6.0	Kalesa per ne fshatrat Marqinet dhe Sharge
2	Km 23+417	6.5	Kalesa per ne fshatin Gjec Koder
3	Km 25+524	5.5	Kalesa ish SMT Preze
4	Km 26+309	5.5	Kalesa Fushe Preze





PËRBËRËSIT KRYESORË TË PROJEKTIT

Bashkia Vorë

- Permirosimi i rrezes së kthesave (Marqinet dhe Sharge);
- Marqinet: toka i perket ish fabrikes se tullave;
- Sharge: toke private (0.5-0.6 ha)

Muret mbajtes: Rreze kodres Marqinet e Shargë



NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Ndikime në cilësinë e ajrit

Pluhuri :

Qarkullimi ne kantier,
pastrimi i bimësisë,
prishja e stacioneve ekzistuese dhe urave e tombinove,
heqja e materialit mbushës në disa pjesë të trasese,
ndërtimi i stacioneve dhe urave e tombinove të reja,
përmirësimi i shtrirjes vertikale dhe horizontale të linjës hekurudhore,
ndërtimi i mureve mbajtës, rehabilitimi i tunelit të Lezhës, etj.), kamionë transporti, etj
Emetimet e gazit do të gjenerohen nga automjetet e transportit dhe pajisjet e ndërtimit.

Djegia e karburantit nga lokomotivat

- **Sperkatje me uje** i zonës së punës gjatë prishjes së stacioneve dhe urave;
- **Vendosja e kantiereve te pune sa më larg** të jetë e mundur nga zonat e banuara, burimet ujore dhe zonat me vlera të larta biodiversiteti;
- **Mbulimi i kamionëve te transportit** dhe dherave e inerteve;
- **Spërkatje e zones se punimeve** dhe **rrugeve ndihmese**, gjatë sezonit të thatë për të minimizuar pluhurin;
- Spërkatje e zones se punimeve për ndërtimin e **rrugëve të shërbimit**, për minimizimin e pluhurit;
- Mbajtja e **PMI**
- Lënda djegëse që do të përdoret për mjetet e punës, të jetë në përputhje me VKM-në nr. 429, datë 26.6.2019
- Të respektohen normat e ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.
- Monitorimi i cilesise se ajrit bazuar ne VKM 352/2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit ne mjedisor dhe standartet mbi disa ndotës”.

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Ndikime në zhurma dhe dridhje

prishja e stacioneve, urave, tombinave, etj., si dhe nga **aktivitetet e ndërtimit** dhe mjetet e transportit, të cilat do të jenë përgjithësisht **makineri te tonazhit te rende**.

Për **prishjen e urave** ekzistuese nuk është planifikuar të përdoret shpërthimi.

Dridhjet në rast përdorimi **lendesh plasese** për prishjen e ndonje ure (p.sh. Ura e Ishmit me afërsisht km 35 + 000).

Burimi kryesor i **zhurmave dhe dridhjeve është ndërveprimi midis rrotave të trenit dhe shinave**, i cili çon në dridhje që perceptohet si zhurmë. Zhurma hekurudhore është

shqetësuese, sidomos nga trenat e mallrave dhe / ose trenat me vagonë ose motorë të vjetër, veçanërisht gjatë natës.

- **Kufizimi i orëve e punës** së makinerive që gjenerojnë zhurmë të lartë / ose dhe dridhje;
- **PMI** per Punëtorët;
- **Kantieret e punes larg** nga zonat e banuara dhe zona me prani faune te eger;
- **Zbatimi i standardeve** dhe praktikave më të mira në rast përdorimi **lendesh plasese** për prishjen e urave ekzistuese;
- Ne rast **shperthimi** lajmerohen **banoret**;
- Kryerja rregullisht e **kontrollit teknik** të makinerive të ndërtimit dhe transportit;
- **Respektimi i normave** per zhurmat dhe dridhjet, sipas Ligjin 9774/2007; “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmave në mjedis”; dhe
- **Monitorimi i zhurmave dhe dridhjeve** nga aktivitetet e projektit, sipas Urdhëreses e MM 1037/1, datë 12.04.2011 “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës ne mjedis”.
- Zbutja e zhurmës në **burim , rrugët e përhapjes**; dhe në **marrës**
- **Minimizimi i ndërtimit** gjatë kohës së riprodhimit të faunës, veçanërisht në zonat e pyllëzuara dhe me shkurre përgjatë hekurudhës nga Bajza në fshatin Hot Ky segment përfshihet në pjesën tokësore të **RMN** të Liqenit të Shkodrës;

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Ndikime në ujërat nëntokësor

Linja hekurudhore përshkon **gjashtë akuifere** të rëndësishëm për furnizimin me ujë të pijshëm

Rrezikun i ndotjes nga **bojërat, vajrat e makinerive, derdhja e karburantit dhe vajit, uji i ndotur etj .;** dhe

Zonat me ndjeshmëri të ulët:

Zonat me ndjeshmëri të moderuar:

Zonat me ndjeshmëri të lartë:

- Shtrati i lumit **Mat:** (km 55 deri km 56):
- në verilindje të Shkodrës: (km 107 deri km 108):

- **Mirëmbajtjen** e rregullt e të gjitha makinerive
- **Sigurimin i pajisjeve** për largimin e rrjedhjeve;
- Mbatja e **automjeteve** dhe makinerive sa me larg ujrave sipërfaqësore dhe **liqenit të Shkodrës;**
- **Kantieret** e punës në **distancën** e duhur nga ujërat sipërfaqësore;
- **Mos ndotje e** ujrave sipërfaqësor nga mbeturinat e gjeneruara ne kantier ujërat e zeza, mbetjet ushqimore, plastikën, etj .;
- **Kantieret** jashtë zonave që preken nga **përmbytjet;**
- **Përdorimi i rrugëve** lokale dhe shmangja e hapjes se ndonjë rruge të re ndihmese për të shmangur gjërryerjen e tokës dhe sedimentimin në ujërat sipërfaqësorë (Liqeni i Shkodrës dhe përrenjtë e zones);
- **Te shmanget grumbullimi i dherave** te germuar afër trupave ujorë;
- Te **minimizohet** punimet në tokë të **butë** në mot të **lagësht;**
- Ne segmentin nga km 107 + 000 në km 108 + 000 aktivitetet e ndërtimit duhet të kryhen gjatë periudhës së thatë, kur niveli i ujrave nentokesore ishte i thelle;
- Ne segmentet ku mbulesa është e përshkueshme (kryesisht nga km 103 + 000 në km 140 + 000), të ndërmerren masa për të parandaluar rrjedhjen e sedimenteve në ujërat sipërfaqësore (lumenjtë dhe përrenjtë dhe Liqeni i Shkodrës) dhe rrjedhimisht nga ujërat sipërfaqësorë në ujërat nëntokësorë;
- Te shmanget shkarkimi i **ujërave të ndotura** drejtpërdrejt në ujërat sipërfaqësorë (**lumenjtë** dhe **përrenjtë**) ose në ujërat nëntokësore (shtresat mbulesore te e përshkueshme;
- Jo ujëra të zeza në tokë gjatë ndërtimit të **urave** dhe **tombinove;**
- **Jo ujera te ndotur në tokë,** veçanërisht nga Bajza në Hanin e Hotit (km 132 deri në km 140) për shkak të **përshkueshmërisë** së lartë të formacioneve gëlqerore.

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Ndikime në ujërat sipërfaqësor

Lumenjtë e kryqëzuar nga hekurudha janë **Ishmi, Droja, Mati, Drini i Lezhës, Drini dhe Kiri**. Derdhen ne Detin **Adriatik**. Përrenjtë kryesorë janë ai i **Vrakës**, Rrjolli, Banushi dhe Perroi Thate. Të gjithë këta përrenj janë të thatë shumicën e vitit. **Prishja** e urave, kanaleve, **ndyshim** i rrjedhes, rritja e **erozionit, rritja e sedimentimit** në rrjedhën e poshtme të urave **Ndotje ,turbullire, ndikim ne flore, faune,**

- **Ndertimi dhe instalimi** gjate stines se **thate**;
- **Urat** e reja mbi lumenjte Ishem dhe Droje do të **ngrihen** për të **rritur kapacitetin** e tyre përcjellës.
- Instalimi/rehabilitimi i dyshekëve me **gabion**
- **Kalatat/kolonat/shtyllat, mbeshtetset/shpatullat e urave** dhe mbrojtja e shpateve anësore do të vendosen gjatë stinës së **thatë**
- Te **shmanget pastrimi i bimësisë** në rrjedhën e sipërme dhe në rrjedhën e poshtme të punimeve mbrojtëse të shpateve anësore.
- **Nese** bimesia **preket** ajo do te **rehabilitohet**
- Do te **permiresohet** sistemi I **kullimit**
- Te **rimbillen** të gjitha zonat e prekura me specie bimesh **autoktone**
- Qe te kemi sa me pak ndikim ne **cilesine** e **ujit, devijimet** e perrenjeve do te behen ne stene te **thate**
- **Kampet e punës** do të vendosen në stacionet e trenit, pra në një **distancë** të përshtatshme nga ujërat sipërfaqësore, zonave që mund të preken nga përmbytjet;
- Te **shmanget** kalimi i **kamioneve** te transportit permes rrjedhave ujore;
- **Përdorimi i rrugëve ekzistuese** lokale dhe shmangja e hapjes se ndonjë rruge të re lidhjeje për të **shmangur erozionin e tokës**;
- **Grumbullimi i mbetjeve** jashtë kantiereve do të ndalohej dhe zonat afër trupave ujqorë do të shmangen;
- Do **minimizohet puna** në tokë të **butë në mot të lagësht**;
- **Ngjeshja** e materialit mbushës të **trupit hekurudhor’** për të parandaluar rrjedhjen në ujërat sipërfaqësore
- Jo veprimtari te tjera ndihmese afer rrjedhave ujore.
- **Miremenbatje e vazhdueshme e linjave**, makinerive për të parandaluar rrjedhjet e vajrave dhe karburanteve

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Përmbytjet

Ne pergjithesi, hekurudha Vorë-Hani Hotit nuk përmbytet nga rrjedhat ujore që pershkon.

Asnjë nga urat kryesore hekurudhore nuk është përmbytur ndonjëherë deri më tani.

Traseja është e ngritur të paktën 2-3 m nga toka.

Tombinot dhe urat e vogla kanë garantuar stabilitetin e trasese.

Punimet në periudhën e reshjeve të dendura mund të shkaktojnë përmbytje të tokës në të dy anet e trasese

Nuk priten ndikime negative të Projektit në **përmbytje** gjatë fazës së **funksionimit**.

- **Kantieret** e punës të vendosen në **distancën** e duhur nga zonat që mund të preken nga përmbytja;
- **Punimet e dheut dhe prishjet e tombinove** te behen në periudhën e **thatë te vitit**;
- **Punimet e ndërtimit** në segmentet që mund të preken nga përmbytja (p.sh. km 32 deri 35 dhe km 70 deri 80) te kryhen në **periudha të thata** dhe per nje kohe sa me te shkurter;
- **Punimet e ndërtimit** të kryhen **paralelisht me përmirësimin e kanaleve kulluese**.
- **Masat e vetme lehtësuese që duhet të ndërmerren kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e sistemit të kullimit (kanalet e kullimit dhe tombinot), si dhe pastrimin e vegjetacionit ne tombino dhe nën ura.**

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Mbetjet	Ndikimet e përkohshme në biodiversitetin tokësor dhe ujq, ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore, cilësinë e tokës dhe shëndetin e punëtorëve dhe popullsisë lokale. Ndikimet e përkohshme në estetikë, biodiversitet, burimet ujore, cilësinë e tokës, trafikun dhe turizmin. Burimet Vajrat, lëndët djegëse, yndyrnat, ngjyruetit, dhe ujërat e ndotura të krijuara nga aktivitetet e ndërtimit, përfshirë fuqinë punëtore. Dherat dhe shkëmbinjtë, bimësia, mbetjet metalike, prej betoni dhe druri, gëlqerorët, rëra dhe zhavorri, mbeturinat e paketimit, të cilat përfshihen në kategorinë e mbetjeve të ngurta;	• Zbatimi I Planit per menaxhimin e mbetjeve • Zbatimi I procedurave per menaxhimin e mbetjeve • Zbatimi I legjislacioni vendas dhe nderkombetar per menaxhimin e integruar te mbetjeve • Shmangjen ose zvogelimi I prodhimit te mbetjeve; • Ripërdorimi, riciklimi ose rikuperimi i mbetjeve si burim energjie; • Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve në një mënyrë sa me miqësore me mjedisin. • Trajtimi i traversave prej druri dhe më pas përdorimi i tyre per prodhim energjie ose ngrohje; ose • Transporti në inceneratorin e Elbasanit, i cili gjeneron energji elektrike
-----------------------	--	---

NDIKIMET MJEDISORE DHE SOCIALE DHE MASAT ZBUTËSE

Mjedisi Biologjik

Humbja, fragmentimi dhe degradimi i habitatit për shkak të të pastrimit të bimesise

Rrugët e shërbimit të ndërtimit, stacionet hekurudhore etj. do të rezultojnë në disa **humbje të përhershme të habitatit**

Rritja e vdekshmërisë (zogjtë folezues, zvarranikët dhe amfibët) për shkak të punimeve të dheut dhe rritjes së ngarkesës së trafikut

Puna ndërtimore dhe prania njerëzore mund të jetë shumë shkatërruese për **kafshët e ndrojtura si zogjtë grabitqarë dhe zogj të tjerë të mëdhenj**, gjitarë etj. Si reagim, ato kafshë priren të **braktisin zonën e projektit**.

Ndotja e ajrit

Ndotja e ujit

Zhurmat dhe ndikimi nga ndricimi i makinerive

- **Zhvillimi i një Plani Monitorimi dhe Menaxhimi të Biodiversitetit**
- **Mospastrim** të bimësisë gjatë sezonit të shumimit
- Jo **shpërthime** gjatë sezonit të riprodhimit (Mar-Gusht)
- **Shmangja** e punës gjatë natës,
- Jo **mbetje të ngurta** në çfarëdo lloji **trupi ujqor** natyror ose artificial.
- **plan emergjence** për të kontrolluar ndotjen në rastet që përfshijnë rrjedhjen e naftës dhe ndotës të tjerë të ujit
- **Shmangja** e ruajtjes së sasive/vëllimit të madh të **mbeturinave**
- Shmangja e vendgrumbullimeve që do të tërhiqnin speciet **gjithëngrënëse** dhe pastrues
- **Kufizim i gjuetisë**
- **Krijoni kalime të kafshëve të egra**
- **Trajnim** i punonjesve për sjelljen me kafshet e egra
- **Zvogëlimi i prerjes së pemëve** gjatë sezonit të shumimit
- Nuk duhen përdorur **lende plasese** (Në Zonen rreth Liqenit të Shkodrës RMN)
- **Rehabilitimi ku është i mundur i pyjeve**, bregore
- Rehabilitimi ku është e mundur, **pylli gjetherënës** i prekur gjatë fazës së ndërtimit

Rrugët e shërbimit: Lidhin qendrat e banuara me kalesat në nivel

	Vendndodhja (km ... ne km ...)	Djathtas /Majtas	Gjatesia (m)	Kategori	Shenim
1	22+100 - 22+160	D	160	C2	Lidh disa shtëpi me kalesen e ish fabrikes se tullave, Vore
2	25+449 - 25+527	D	78	C2	Lidh disa shtëpi me kalesen e ish SMT, Preze
3	26+266 - 26+309	D	45	C2	Lidh disa shtëpi me kalesen e ish SMT, Preze
4	20+773 - 22+140	M	167	F2	Rruge e re, per te lidhur fshatrat Marqinet dhe Sharge me kalesen e ish fabrikes se tullave dhe me stacionin Vore.
5	23+370 - 23+414	M	44	C2	Permireson nje rruge ekzistuese, ne Gjec Koder, e cila lidhet me kalesen ne nivel per ne kete fshat
6	23+422 - 23+451	M	29	C2	Permireson nje rruge egzistuese, ne Gjec Koder, e cila lidhet me kalesen ne nivel per ne kete fshat
7	24+195 - 25+400	M	1205	C2	Lidh nje lagje te Gjec Koder e F. Preze me kalesen e ish SMT, Preze
8	25+524 - 25+595	M	71	C2	Permiresim rruge egzistuese, e cila lidhet me kalesen e ish SMT, Preze
9	26+230 - 26+309	M	79	C2	Ahmetaq; Permiresim rruge qe lidhet me kalesen Fushe Preze

Ndikimet Mjedisore dhe Sociale dhe Masat Zbutëse

Ndikime në marrjen e tokës	Blerje e përhershme e tokës dhe marrje e përkohshme me qera Ndikime në nivelin e jetesës si pasojë e marrjes së tokës	• Minimizimi i marrjes e tokës për projektin hekurudhor përmes zgjidhjeve të projektimit. Për shembull, për të shmangur marrjen e tokës përgjatë shtrirjes, përdorimi i mureve mbajtëse në fund të shpateve; • Kur përmirësohen rrugët lokale, kërkimi i një zgjidhje projektimi që kërkon më pak tokë nga pronat ngjitur; • Mbështetja e grupeve dhe individëve në nevojë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për marrjen e Certifikatës së Pronësisë; • Ndjekja e Ligjit Shqiptar dhe standarteve të BERZH në procesin e marrjes së tokës dhe vlerësimit; • Kryerja e inventarizimit dhe Planit të Zhvendosjes duke identifikuar pronarët dhe përdoruesit e tokës;
-----------------------------------	--	---

Ndikimet Mjedisore dhe Sociale dhe Masat Zbutëse

Ndikimet në shëndetin dhe sigurinë (Profesionale dhe Komunitare)	Emetimi i pluhurit dhe grimcave; Emetimi i zhurmës dhe dridhjeve; Rritja e rrezikut të rreziqeve të trafikut dhe incidenteve të lidhura me transportin e materialeve në rrugët lokale; Mbyllja e vendkalimeve ekzistuese në nivel të paautorizuar dhe nevoja për të ecur / udhëtuar një distancë më të gjatë për të kaluar në anën tjetër të linjës hekurudhore;	• Komunitetet lokale informohen me kohë për mbylljen e rrugëve, punimet në rrugë apo përdorimin e mjeteve të rënda; • Planifikimi dhe zbatimi i fushatave sensibilizuese për rreziqet që lidhen me rritjen e trafikut, në shkollat e pranishme në zonë dhe grupet në nevojë; • Njoftimi nëpërmjet pushtetit vendor të gjithë banorët e zonave të prekura për të koordinuar fluksin e trafikut për përdoruesit lokalë; • Njoftime të rregullta për banorët lokalë në lidhje me rreziqet e mundshme të projektit dhe ndryshimet në aktivitetet e projektit që mund të kenë ndikime në sigurinë e komunitetit; • Përgatitja dhe aplikimi i Planit të Reagimit Emergjent; • Shëndeti dhe siguria e punëtorëve menaxhohet në përputhje me rregulloret kombëtare, standartet e BERZH dhe standardin ISO 45001.
---	--	--

Ndikimet Mjedisore dhe Sociale dhe Masat Zbutëse

Ndikimet në Transport dhe Trafik	Rritja e trafikut; Rritet rreziku i aksidenteve rrugore; Vonesat e mundshme për aksesin në punë, objektet e kujdesit shëndetësor, shkolla, etj. për shkak të bllokimeve të trafikut dhe mbylljes së vendkalimeve në nivel për shkak të aktiviteteve ndërtimore përgjatë vijës hekurudhore; Ndërprerje/kufizim i infrastrukturës/shërbimeve. Rritja e dridhjeve dhe trafikut në zonat pranë rrugëve hyrëse.	• Planifikoni rrugët e transportit në bashkëpunim me bashkinë, drejtorinë rrugore dhe policinë; • Shmangia e aktiviteteve të transportit, veçanërisht ato që përfshijnë automjete të rënda të mallrave gjatë orëve të pikut; • Kryerja e një studimi të detajuar të trafikut të rrugëve hyrëse që do të përdoren për projektin e rehabilitimit të hekurudhës. Të dhënat do të përdoren për të shmangur orët e larta të trafikut për komunitetet lokale dhe ofrojnë të dhëna për zhvillimin e Planit të Menaxhimit të Trafikut; • Vlerësimi i ndërtesave dhe shtëpive të pranishme gjatë rlevimeve të parandërtimit në afërsi të rrugëve dhe rrugëve hyrëse që do të kryhen përpara fillimit të punimeve dhe monitorimi i vazhdueshëm i kushteve të ndërtesave • Ndërtimi i vendkalimeve të këmbësorëve (në nivel, mbikalime dhe/ose nënkalime).
--	--	---

Ndikimet Mjedisore dhe Sociale dhe Masat Zbutëse

Ndikime në ekonomi dhe punësim	Kërkesa për fuqi punëtore; Kërkesa për mallra, materiale dhe shërbime. Zinxhiri i furnizimit të projektit (mallra dhe shërbime);	• Vendorsja e procedurave transparente dhe të drejta të rekrutimit duke ndjekur kërkesat e Kodit Shqiptar të Punës; Konventat e ILO-s të ratifikuara nga Shqipëria; Standartet e BERZH; • Prioritet për punësimin e anëtarëve të grupeve dhe individëve në nevojë; • Informacioni mbi mundësitë e prokurimit do t'u jepet bizneseve lokale, përmes komunikimit të përshtatshëm me autoritetet lokale dhe palët e tjera; • Projekti do të ofrojë informacion mbi proceset e prokurimit, tenderimit dhe kontraktimit me një qasje transparente dhe të qartë, për të siguruar që të garantohet akses i barabartë në mundësi; • Projekti do të zhvillojë një Plan të Menaxhimit të Rekrutimit dhe Punës (RLMP) që detajon strategjinë për maksimizimin e punësimit lokal dhe specifikon kushtet e punësimit të punëtorëve;
--------------------------------	---	--

Angazhimi me Palët e Interesit

- Angazhim i vazhdueshëm me personat e prekur nga Projekti dhe me të gjitha palët e interesit në nivel kombëtar dhe lokal
- Angazhim me palët gjatë fazës së studimit të tokës dhe Planit të Zhvendosjes Ekonomik
- Takime të dedikuara për të informuar për fillimin e punimeve dhe për fazat e punimeve
- Informim mbi punimet edhe nëpërmjet kontraktorëve dhe tabelave informative

Faleminderit!

